



REPUBLIKA E KOSOVËS : REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranuar - Prizajera më 20-05-2014 vit/god.			
Nr./Organit Org.broj	Numri/Broj	Shtojcë Prilog	Vlera Vendoset
02	035/02		745



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr 03/L-040 në harmoni me me nenin 51.1 të Statutit të Komunës së Vitisë 01 nr 013/491 të datës 21.04.2011, neni 17 paragrafi 1 lidhur me neni 39 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 të Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjesit nr. 03/L-048, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Prishtinë III/Nr.27/03 Qershor 2008, Kryetari i Komunës, në bazë të kompetencave dhe autorizimeve ligjore nxjerr këtë:

V E N D I M

Për Respektim të Afateve Ligjore për të gjitha Njesit Shpenzuese në Komunën e Vitisë


- I. Kryetari i Komunës nxjerr vendim për të gjitha Njesit shpenzuese në komunën e Vitisë për rrespektim të afateve ligjore konform neni 17 paragrafi 1 lidhur me neni 39 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 të Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjesit nr. 03/L-048.
- II. Detyrohen të gjithë Drejtorët, përgjegjesit dhe të gjitha ata të cilët procedojn faktura si në pikën 1 të dispozitivit të rrespektojnë afatet ligjore.
- III. Detyrohet Drejtoria e Financave në Komunën e Vitisë që të bëjë ekzekutimin e pagesave në harmoni me afatin ligjore prej 30 ditëve.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës

A r s y e t i m

Mbeshtetur në dispozitat e lartëcekura kryetari i Komunës nga të gjitha njesit shpenzuese në komunën e Vitisë që pagimi i fakturave të bëhet në harmoni me afatet ligjore.

Paratë publike do të përdoren vetëm për qëllime të miratuara publike. Asnjë autoritete publik, organizatë buxhetore, person apo ndërrmarrje nuk mund të devijojnë, keq zbatojnë, ekspozojnë apo të përdorin në menyrë të parregullt paratë publike. Kryetari i Komunës kërkon që detyrimisht nga drejtorët e të gjitha drejtorive për të siguruar që cdo fature e vlefshme dhe kërkesë për pagimin e mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhet brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarik pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim nga organizata përkatëse buxhetore.

Kryetari i Komunës
Sokol Haliti



Këshillë Juridike: Kunder këtij vendimi mundet të paraqitet Ankesë komisionit të Ankesave në Komunën e Vitisë në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të këtij vendimi.